



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2500/2 prot.

Datë 10.09.2024

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E
OFERTUESVE TË TJERË DUKE REFERUAR VETËM KRITERET PËR TË CILAT
NGRIHEN PRETENDIME

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Filara” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-11979-07-03-2024, me objekt: “Botime, printime dhe materiale shtypshkrimi për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” me fond limit 22,099,417.66 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 05-08-2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.
- Ankimues:** “Inpress” SHPK me NIPT L52122014L dhe adresë Ish Blloku i Magazinave te Tregtise, Rruga Siri Kodra.
- Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Blerjeve te Perqendruara
Adrese: Blv ”Dëshmorët e Kombit” NR.3, 1001, Tiranë
- Subjekte të Interesuara:** “Filara” SHPK me NIPT K51611059N dhe adresë: Adresa: Tirane, Rruga Kavajes, Ish kombinati "Misto Mame", Prane fabrikes "Kaon"

Në datën 06.09.2024 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2024/4528 si dhe nr. Protokolli 2500/2024 datë 09.09.2024 i operatorit ekonomik “Inpress” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-11979-07-03-2024, me objekt: “Botime, printime dhe materiale shtypshkrimi për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” me fond limit 22,099,417.66 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 05-08-2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga “Filara” SHPK në procedurën e prokurimit.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) **pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime**”.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime se ofertuesi “Filara” SHPK nuk përmbush kërkesat/kriteret si me poshte:

***. “ . SË Pari, NË kundërshtim me gërmën iëë, të pikës 3, të nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 ipër Prokurimin Publikë i ndryshuar dhe të shtojcës 8, Kriteret e përgjithshme të Kualifikimit të DST, ...Operatori ekonomik Filara shpk. Ndodhet në kushtet e skualifikimit të detyrueshëm, pasi ë...Operatori ekonomik Filara shpk. Ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncensionare që ka cuar në përfundimin e kësaj kontrate.

Nisur nga sa mësipër, gjykojmë se AK Operatori i Blerjeve të përqendruara do të duhet të skualifikojë OE Filara shpk., pasi ky operator ekonomik ndodhet në kushtet e skualifikimit të detyrueshëm, bazuar në gërmën e të pikës 3, të nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 për Prokurimin Publikë i ndryshuar.

*** Ofertë Anomalisht e Ulet.

2.3.3 Operatorët ekonomikë duhet të ketë personelin teknik të nevojshëm për realizimin e e shërbimit objekt prokurimi, si më poshtë:

- a) 1 (një) përgjegjës shërbimi,
- b) 1 (një) punonjës grafik- dizajner
- c) 2 (dy) punonjës ndihmës,
- d) 1 (një) shofer.

Për punonjësit në pikat a dhe c duhet të paraqitet: kontratë pune, të vlefshme.

Për punonjësin në pikën b duhet të paraqitet:

- diplomë e shkollës së lartë dhe/ose Dëshmitë e aftësisë profesionale, për secilin punonjës, sipas Ligjit Nr.15/2017, ”Mbi arsimin dhe formimin profesional”, i ndryshuar, që vërteton se punonjësi ka njohuri në fushën e grafik-dizajnit;
- kontratë pune, të vlefshme

Për shoferin duhet të paraqitet:

- kontratë pune, të vlefshme,
- Leje drejtimi

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT.

Dokumentet provuese të kërkuar më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë minimalisht pajisjet e nevojshme për zbatimin e kontratës, si vijon:

- Makinë shtypi me format min 50 cm x 70 cm; 2 (dy) copë
- Makinë qepëse 2 (dy) copë
- Makinë telefoni; 2 (dy) cope

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet:

dokumentacion për pajisjet dhe instrumentet e mësipërme, që vërtetojnë se, këto pajisje dhe instrumente i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë). Dokumentacioni i paraqitur duhet të përmbajë të dhëna të mjaftueshme për identifikimin e qartë të makinerive pajisjeve të kërkuara.

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT.
Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 10.09.2024

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Fiorent Zguro	Anila Malaj	Kreshnik Ternova	Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri